



Pranuar / Dostigjen Priljena / Pri data Received / Delivery	03.03	2021	1	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	SKDMSHCK	944/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.19/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.19/2021 të datës 20.01.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr."Shkodra" Nr.6, Komuna e Prishtinës, në çështjen administrative-juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 02.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.19/2021, e datës 20.01.2021, e parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet masa disiplinore "Vërejtje" e shqiptuar përmes shkresës me numër protokollit 0303/2918/20 të datës 22.12.2020, si dhe çdo veprim tjetër i pasuar lidhur me masën disiplinore.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja Zyrtare për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pran Agjencisë Kundër Korrupsionit, me datë 20.01.2021 ka prashtruar ankesë me numër protokollit 219/2021, të regjistruar me A.nr. 19/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejtje" të shqiptuar nga Udhëheqësja e Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, përmes shkresës me numër protokollit 0303/2918/20 të datës 22.12.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 29.01.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kundër Korrupsionit, ndërsa me datë 03.02.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës fq. 1/35.

Kolegj për shqyrtimin e ankesës dhe vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 20.01.2021 me numër protokoll 219/2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.01.2021; E-mailin e datës 19.01.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.12.2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.12.2017; Vërejtjen me shkrim të datës numër protokoll 0303/2918/20 të datës 22.12.2020; Raportin e datës 08.09.2020; E-mailin e datës 07.10.2020; E-mailin e datës 13.10.2020; E-mailin e datës 08.10.2020; E-mailin e datës 03.12.2020; E-mailin e datës 27.11.2020; E-mailin e datës 06.11.2020; E-mailin e datës 28.09.2020; E-mailin e datës 28.09.2020; E-mailin e datës 23.09.2020; E-mailin e datës 23.09.2020; E-mailin e datës 19.01.2021; E-mailin e datës 18.01.2021; E-mailin e datës 18.01.2021; E-mailin e datës 22.12.2020; E-mailin e datës 18.01.2021; E-mailin e datës 22.12.2020; E-mailin e datës 18.01.2021; E-mailin e datës 18.01.2021; E-mailin e datës 22.12.2020; Përgjigjen në ankesë të datës 03.02.2021; E-mailin e datës 13.10.2020; E-mailin e datës datës 02.02.2021; E-mailin e datës 22.12.2020; E-mailin e datës 02.02.2021; E-mailin e datës 18.01.2021; E-mailin e datës 22.12.2020; E-mailin e datës 02.02.2021; E-mailin e datës 19.01.2021; E-mailin e datës 18.01.2021; E-mailin e datës 22.12.2020; E-mailin e datës 02.02.2021; E-mailin e datës 02.02.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit se janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës në pajtim me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses

është e bazuar, sepse:

Në ankesën e prashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankuesja pretendon se "Vërejtja", e shqiptuar nga Udhëheqësja e drejtpërdrejt e saj përmes shkresës me numër protokoll 0303/2918/20 të datës 22.12.2020, nuk ka bazë ligjore, sepse nuk janë saktësuar shkeljet e bëra dhe se nuk është dhënë udhëzimi i qartë lidhur me të drejtën e ushtrimit të mjeteve juridike. Me tutje kërkon nga Këshilli që të aprovohet ankesa dhe të hedhet poshtë si e pa bazuar masa disiplinore "Vërejtje" e datës 22.12.2020.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesës ka konstatuar se ankuesja është nëpunëse e shërbimit civil në Agjencinë Kundër Korrupsionit, e sistemuar në pozitën e punës Zyrtare e Lartë në Divizionin për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik.

Udhëheqësja e Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik në cilësinë e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të ankueses, me datë 22.12.2020 ka shqitura masën disiplinore "Vërejtje", ndaj ankueses me arsyetimin se ankuesja e ka akuzuar, fyer dhe penguar në punë.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, me të cilën është rregulluar procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil, ndërsa në kuptim të përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore, Kolegji ju referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ka përcaktuar se përgjegjësia disiplinore është *moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.* Andaj bazuar në këtë përcaktim ligjor, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se organi

kompetent respektivisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo Komisioni Disiplinor duhet të kenë parasysh të gjitha elementet e lartëcekura, me rastin e vërtetimit të përgjegjesisë disiplinore të nëpunësit civilë.

Kolegji gjatë shqyrtimit provave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, ka konstatuar se udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore të kontestuar nuk ka bërë kualifikimin juridik të shkeljeve disiplinore që supozohet të jenë kryer nga ankuesja, e qe përbenë parakusht ligjor për shqiptimin e masës disiplinore në raport me shkeljen e konstatuar, kështu që pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i bazuar.

Kolegji po ashtu gjatë analizimit të provave të lëndës ka vlerësuar se udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje", nuk ka marrë parasysh parimet për individualizimin e masës disiplinore siç kërkohet me nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku shprehimisht thuhet se: *"Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit.* Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja për vitin 2017 dhe 2019 ka vlerësime të mira të rezultateve në punë dhe se me asnjë shkresë nuk vërehet se ndaj ankueses është shqiptuar me parë ndonje masë disiplinore e natyrës se tillë apo e ngjashme, andaj Kolegji vlerëson se organi kompetent, respektivisht udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses është dashur të marrë parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit ndaj ankueses se masës disiplinore "Vërejtje" të datës 22.12.2020.

Ndërsa, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se masa disiplinore "Vërejtje me shkrim" nuk përmbanë udhëzime të qarta për të drejtën e ushtrimit të mjeteve juridike, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke marrë parasysh se marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil është marrëdhënie juridike e së drejtës administrative, dhe se masa disiplinore prodhon pasojë juridike për palën, Kolegji vlerëson se masa disiplinore e kontestuar është në kundërshtim me nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht nuk përmban pjesën përmblylëse apo këshillën ligjore lidhur me ushtrimin e mjeteve juridike, si element i detyrueshëm i aktit administrativ, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.5 si dhe nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A. Nr. 19/2021

Çlirim Zeka

Zeka
Zyrtar për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kundër Korrupsionit
- Arkivit të KPMSHCK-së